


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 73 Rep.

NR. 12 Kol.



KONTRATË SHITJE AKSIONESH



Sot me datë 04.04.2006 (dy mijë e gjashtë) para meje Noteres Lirijona Elona Tiranë, u paraqitën personalisht palët dhe më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate shitje aksionesh.

SHITËSI: **Agim Ramaj** i biri i Rexhepit dhe i Milicës, i dtl 1957, banues në Tiranë, me letërnjoftim EV Nr 496187, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar,

BLERËSIT: **Astrit Hana** i biri i Sulejmanit dhe i Fatimesë i dtl 12.02.1940, banues në Tiranë, me pasaportën Nr Z 0040676, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar,
Artan Kripa i biri i Reshatit dhe i Idës i dtl 19.04.1966, banues në Tiranë, me pasaportën Nr Z 1260770, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar,

Shitësi Agim Ramaj është aksioner në shoqërinë "MEDIASAT"SHA, në bazë të Vendimit të Gjykatës Nr.23760 dt 09.05.2000 për regjistrimin e shoqërisë si person juridik, në 40% të aksioneve që përbëjnë kapitalin themeltar, ndërsa blerësit Astrit Hana dhe Artan Kripa, dëshirojnë të blejnë aksionet e aksionerit Agim Ramaj, secili nga ½ pjesë, të barabarta me 20% të aksioneve që përbëjnë kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Në bazë të Vendimit Nr 16 te dt. 12.01.2006 të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë "MEDIASAT" SHA, shitësi Agim Ramaj, duke qenë aksioner i shoqërisë me 40 % të aksioneve, ja shtet zotërinjve Astrit Hana dhe Artan Kripa, duke u bërë këta të fundit aksionerë të shoqërisë "MEDIASAT" SHA, secili me nga 20 % të aksioneve që përbëjnë kapitalin themeltar.

Edhe blerësit Astrit Hana dhe Artan Kripa, janë dakort dhe pranojnë blerjen e aksioneve të mësipërme secili për shumën **50.000 Lekë**, duke zotëruar kështu secili 20% të aksioneve të Shoqërisë tregtare "MEDIASAT" SHA.

Përfundimisht me anë të kësaj kontrate shitje:

Z. Astrit Hana zotëron 20% të aksioneve të shoqërisë "MEDIASAT" SHA dhe

Z. Artan Kripa zotëron 20% të aksioneve të shoqërisë "MEDIASAT" SHA

duke u bërë të dy këta persona, aksionerë në këtë shoqëri.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala shitëse, Agim Ramaj, humbet të drejtën e aksioneve të shitura në masën 40%, ndërsa blerësit bëhen pronarë secili të 20% të aksioneve të blera nga aksioneri Agim Ramaj.

Kjo kontratë shitje përpilohet në bazë të Vendimit Nr 16 dt 12.01.2006 të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionerëve të shoqërisë "MEDIASAT" SHA bashkëngjitur kësaj kontrate.

Kontrata u përpilua në katër kopje me vlerë të njëjtë ligjore, iu lexua palëve kontraktuese me zë të lartë, u kuptua prej tyre dhe palët shprehën vullnetin e tyre të lire e të plotë dhe kjo kontratë u nënshkrua rregullisht prej tyre para meje ndaj unë Noterja e vërtetoj sipas ligjit.



SHITËSI

Agim RAMAJ

Agim Ramaj

BLERËSIT

Astrit HANA

Astrit Hana

Artan KRIPA

Artan Kripa

NOTERE

[Signature]